



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:014315

Datë: 01.02.2024

Numri i dokumentit: 05362113

PS.nr.76/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti Special, Kryetari i Trupit Gjykes-gjyqtari Lutfi Shala, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Luljeta Gashi Metaj, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarit **Sh. Xh.**, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës **PPS.nr.112/22 të dt.28.12.2023**, për veprën penale Ushtrim i Ndikimit nga neni 424 paragrafi 1 të KPRK-së, në seancës dëgjimore publike për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, me dt.31.01.2024, ku prezencë ishin të prokurorit të PSRK-së D. P., i akuzuari Sh. Xh., me mbrojtësin e tij me autorizim Av .A.A.gjykata me datë 01.02.2024, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

Sh.Xh., nga i ati Z., e ëma B., e gjinisë së nanës M., i lindur me datën ..., në fsh. D., ku edhe jeton në "M.Xh.", nr., komuna V., i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion fermer –pronar i biznesit:"Sh. Xh.", i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal të identifikimi..., ka qëndruar nën masën e paraburgimit dhe në arrest shtëpiak prej dt.... deri me dt.....

ËSHTË FAJTORË

Sepse:

Nga data 28.12.2022 deri me datë 16.01.2023, në V. dhe në P., i pandehuri Sh. Xh. me dashje në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkon dhe pranon përfitim pasurorë për vete me premtimin se do të ushtrojë ndikim të padrejtë mbi vendimmarrjen e personave zyrtarë në A. për Zh. e B., në atë mënyrë që fillimisht i pandehuri Sh.Xh., duke pasur dijeni se aplikuesi B.G., kishte aplikuar në emër të familjares M. G. për vitin 2022, për përfitimin e grantit në projektet Investimet, në asetet fizike të ekonomike bujqësore dhe kishte dijeni se Sh. Xh. kishte aplikuar për grant dhe ishin në pritje të rezultatit, takohet disa herë me B. G. dhe kërkon para në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe përmes tij në mënyrë të tërthortë, kërkon para edhe nga Sh. Xh., me premtimin se do të ndikojë

te zyrtarët në A.për Zh. e B., për të përfituar grantet dhe gjatë aplikimit të masave të veçanta të simulimit të veprës së korrupsionit me dt.... rreth orës 19:00, në restorantin e H. P. në Sh., i pandehuri takohet me B.G. dhe hetuesin ..., dhe sipas marrëveshjes paraprake pranon shumën 12.000.00€, dhe menjëherë pasi del nga vetura arrestohet dhe paratë e përdorura në simulim gjenden në posedim të i pandehuri Sh. Xh.,

Me këto veprime i akuzuari Sh. Xh.ka kryer veprën penale Ushtrim i Ndikimit nga neni 424 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 7, 8, 9, 10, 17, 38, 39, 40, 42,43, 69, 70,71, 79, të KPRK-së, si dhe neni 230, 360, 361, 364 dhe neni 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të akuzuarit **Sh.Xh.**, për veprën penale Ushtrim i Ndikimit nga neni 424 paragrafi 1 të KPRK-së e:

GJYKON

Me **Dënim me gjobë** në shumën prej **5000 (pesë mijë) euro**, si dhe **Dënim BURGIMI** në kohëzgjatje prej **8 (tetë) muaj**.

Dënimin me gjobë i akuzuari duhet ta përmbush 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas plotëfuqishmerisë së aktgjykimit, ndërsa dënimin me burgim, do ta mbajë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas plotëfuqishmerisë së këtij Aktgjykimi.

Koha e kaluar në masën e paraburgimit, prej datës **16.01.2023** e deri me datën 15.04.2023 si dhe koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak prej datës 15.04.2023 **deri më datën 15.06.2023**, i llogaritet në dënimin e shqiptuar, me burgim.

Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform neni 43 par.3 të KPRK-së, të njëjtit gjykata do ta zëvendësoj me dënim me burgim, duke llogaritur për çdo 20 (njëzet) euro, me 1 (një) ditë burgim.

OBLIGOHET i akuzuari, që në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës të ia kompensojë shumën prej **100 (njëqind) euro**, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **50 (pesëdhjetë) euro**, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej **50 (pesëdhjetë) euro** të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë PPS.nr.112/22 të dt.28.12.2023, kundër të akuzuarit **Sh. Xh.**, për veprën penale Ushtrim i Ndikimit nga neni 424 paragrafi 1 të KPRK-së.

Së bashku me aktakuzë me dt.29.12.2023 Prokuroria Speciale, ka paraqitur edhe Marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, të lidhur e të nënshkruar në mes të Kryeprokurorit, prokurorit të çështjes, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, lidhur me veprën penale: Ushtrim i Ndikimit nga neni 424 paragrafi 1 të KPRK-së, në të cilën marrëveshje është përcaktuar edhe dënimi i rekomanduar për të akuzuarin.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore me dt.31.01.2024, për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, e në të cilën seancë i

akuzuari pasi është njoftuar me të drejtat e tij në këtë çështje penale, ka deklaruar se ka kuptuar aktakuzën dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, dhe se nuk ka nevojë për ndonjë sqarim shtesë, dhe se ndihet fajtorë për veprën penale Ushtrim i Ndikimit nga neni 424 paragrafi 1 të KPRK-së.

Prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës D. P., në seancën dëgjimore, për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, të parashtruar me shkrim, ka deklaruar se: fillimisht nga mbrojtësi i të akuzuarit, ka pranuar kërkesë për të filluar negociatat për pranimin e fajësisë. Me autorizim të Kryeprokurorit me dt.28.12.2023 prokurori i rastit, ka mbajtur seancë për negociim të marrëveshjes për pranimin e fajësisë ku janë pajtuar, pasi që i pandehuri Sh.Xh.ka pranuar fajësinë, se ka kryer veprën penale Ushtrim i Ndikimit nga neni 424 par.1 të KPRK-së dhe prokurori i ka rekomanduar gjykatës, që të pandehurit Sh. Xh. ti shqiptohet dënim me gjobë 5000 euro dhe dënim me burg prej 8 muaj. Konsideron se marrëveshja e lidhur është në harmoni me KPPRK-në, me vullnet të lirë, duke e njoftuar të pandehurin edhe një herë për benefitet që i ofron kjo marrëveshje. Gjykatës i ka propozuar që këtë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë ta aprovojë sepse e njëjta është lidhur konform dispozitave të KPPRK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.Xh., av. A.A., në seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar: se mbesin në tërësi pranë marrëveshjes së lidhur e me të cilën edhe janë pajtuar andaj edhe sot kërkojnë që të njëjtën ta aprovojë mirëpo nga gjykata ka kërkuar që të ketë parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit, me rastin e matjes së dënimit ndaj të mbrojturit të tij.

I akuzuari Sh.Xh., ka deklaruar se pajtohet me fjalët e mbrojtësit të tij dhe e ka të qartë marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

Gjykata gjatë shqyrtimit të pranimit apo mospranimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, pas dëgjimit të prokurorit special, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, e konform nenit 230 par. 17 të KPPRK-së, përcaktoi se i akuzuari: në tërësi ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe se nuk ka qenë i detyruar ose shtrënguar në asnjë mënyrë që ta pranojë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale të rastit konkret, të cilat paraqiten në aktakuzë dhe nuk ekziston asnjë nga rrethanat e paraqitura në nenin 248 par. 1 dhe 2 të këtij Kodi.

Gjykata pas marrjes së mendimit të prokurorit special, mbrojtësit të të akuzuarit dhe të akuzuarit dhe pasi që është bindur se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara në paragrafin e 17 të nenit 230 të KPPRK-së, komfor nenit 230 par. 21 të KPPRK-së, me **AKTVENDIM** pranoi Marrëveshjen për pranimin e fajësisë të lidhur ndërmjet Kryeprokurorit të PSRK dhe Prokurorit Special në një tërësi anë, si dhe të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij në anën tjetër dhe urdhëroi që Marrëveshja të vendoset në shkresat e lëndës së kësaj gjykate, e që palët në procedurë janë pajtuar me pranimin e marrëveshjes se pranuar nga gjykata pa asnjë vërejtje.

Në marrëveshjet për pranimin e fajësisë dhe deklaratat e prokurorit special, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprës penale, për të cilën akuzohet.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata i pati parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për veprat penale për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor,

pastaj pati parasysh edhe qëllimin e dënimit dhe të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese nga 69 dhe neni 70 të KPRK-së, që ndikojnë në ashpërsimin ose zbutjen e dënimit.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit për të akuzuarin **si rrethana rënduese** ka gjetur **Shkallën e përgjegjësisë penale** pasi që gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këtë veprë penale, i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij, si dhe shkallën e lartë të pjesëmarrjes, **Motivin për kryerjen e veprave penale** i njëjti me dashje dhe me vetëdije ka vepruar me qëllimin të caktuar për përfitim të vlerave të ndryshme monetare të cilat i njëjti j'ua ka kërkuar në mënyrë të drejtë për drejtë të dëmtuarve, **Intensiteti i rrezikimit apo i dëmtimit të së mirës së mbrojtur** gjykata ka marrë parasysh se i njëjti me veprimtarin e tij ka premtuar se do të ushtrojë ndikim të padrejtë mbi vendimmarrjen e personave zyrtarë në A. për zh. e B., **rrethanat në të cilat është kryer vepra penale**, i njëjti ka ushtruar veprimtari të kundërligjshme, duke e paraqitur veten si person me ndikim në M. e B., dhe duke e shfrytëzuar gjendjen e të dëmtuarëve, i ka nxitur që të paguajnë shuma të ndryshme të parave, **shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale**, pasi që i njëjti me veprimet e tij thellësisht i ka kontribuar kryerjes së kësaj veprë penale dhe se veprat penale i ka konsideruar si të vet.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese mori faktin se, i njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sinqertë, gjithashtu vlerësoi sjelljen e tij korrekte në gjykatë gjatë shqyrtimit të pranimit e fajësisë, e të gjitha këto të përfshira në marrëveshjen për pranimit e fajësisë, në të cilën janë dakorduar për vendimin mbi dënimin dhe lartësinë e tij, e duke pasur parasysh se gjykata e pranoi Marrëveshjen për pranimit e fajësisë.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë tek të tjerët që të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit, konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për llogaritjen e kohës së kaluar në masën e paraburgimit në dënimin me burgim është marrë konform nenit 79 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale (paushallin gjyqësor), është marrë konform neneve 450, të KPPRK, pasi që gjykata në këtë çështje penale ka marrë aktgjykim dënues.

Vendimi lidhur taksën për programin e kompensimit të viktimave u mor konform nenit 39 par 3, pika 31.1, të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimit (Ligji nr. 05/L036).

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit, 364, 365 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti Special
PS.nr.76/2023, me datën 01.02.2024

Bashkëpunëtorja profesionale

Kryetari i trupit gjykues

Luljeta Gashi-Metaj

Lutfi SHALA

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.